



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Referuar kërkesës për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit më datë 29.05.2026 nga Z. Sabri Osmani bëjmë me dije si vijon:

Çështja është regjistruar në Platformën e Bashkëqeverisjes me nr. 937915, datë 29.04.2026, nga z. Sabri Osmani, me objekt kërkesën për informacion lidhur me dosjen për legalizimin e ndërtimit informal, depozituar pranë DV ASHK Shkodër-Pukë si dhe pajisjen me kopje të dokumentacionit përkatës.

Pas verifikimit paraprak të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, bazuar në pikën 1 të nenit 40 të ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”, në datën 29.04.2026 është kryer delegimi i rastit pranë ASHK-së, Drejtoria e Përgjithshme. Në të njëjtën datë, kjo e fundit ka informuar se ankesa e sipërcituar është deleguar për kompetencë pranë DV ASHK Shkodër-Pukë.

Pas marrjes së përgjigjes nga ASHK Drejtoria e Përgjithshme, në datën 29.04.2026 është kryer delegimi për trajtimin e ankesës pranë DV ASHK Shkodër-Pukë, me kërkesë për trajtimin e ankesës dhe kthimin e përgjigjes shteruese.

Më datë 13.05.2026 (datë e përfundimit të afatit 10-ditor për trajtimin e ankesës), ju jeni informuar për të qëndruar në pritje të përgjigjes përfundimtare. Në të njëjtën datë, është dërguar edhe rikujtesë pranë DV ASHK Shkodër-Pukë për trajtimin e ankesës tuaj, pasi ishin tejkaluar afatet ligjore të trajtimit sipas ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”. Pas kësaj rikujtese të bërë nëpërmjet platformës, nuk rezulton të ketë pasur përgjigje nga institucioni lidhur me trajtimin e ankesës.

Më datë 28.05.2026, jeni riinformuar për të qëndruar në pritje të përgjigjes përfundimtare të institucionit. Gjithashtu, në të njëjtën datë është dërguar një rikujtesë e dytë pranë DV ASHK Shkodër-Pukë për trajtimin e ankesës, pasi afatet ligjore të trajtimit, sipas ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”, vijonin të ishin të tejkaluara.

Rasti është verifikuar dhe trajtuar në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së dhe DV ASHK Shkodër-Pukë, çka ka sjellë një kohë më të gjatë trajtimi të çështjes.

Në përfundim, bëjmë me dije se ditën e sotme, datë 18.06.2026, rasti juaj ka marrë përgjigje nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, duke ju vënë në dispozicion informacionin mbi procesverbalin e nxjerrjes për punim të dosjes së legalizimit të objektit informal.

Në vijim të sa më sipër, rasti juaj do të vijojë trajtimin deri në zgjidhjen shteruese, sipas afateve procedurale të institucionit kompetent, konkretisht DV ASHK Shkodër-Pukë.

Gjithashtu, sipas kërkesës DV ASHK Shkodër-Pukë ka informuar se do t’ju pajisë me një kopje të dokumentacionit të dosjes së legalizimit në posedim të Sabri Seit Osmanit.